

Çfarë informacioni mund të merrni online dhe pa pagesë?

Nëse konsultoni faqen web www.gjykata.gov.al ju do të gjeni informacion mbi:

- Gjykatën për të cilën ju interesoheni;
- Çështjet civile dhe penale;
- Statistikat;
- Shortin;
- Kalendarin e seancave;
- Mbledhjet e Këshillit të Gjykatës;
- Njoftime për publikun e median dhe publikime;
- Shpalljet publike;
- Aktet e brendshme të Gjykatës;
- Programin e transparencës dhe të dhënat e kontaktit të koordinаторit për të drejtën e informimit;
- Formularë aplikimi;
- Tarifat për shërbimet;
- Listat e avokatëve kryesisht, ekspertëve, ndërmjetësve, psikologëve, etj.

Nëse informacioni nuk gjendet online çfarë mund të bëj?

Ju mund ti drejtoni një kërkesë për informim koordinatorit për të drejtën e informimit në secilën gjykatë, duke plotësuar formularin sipas këtij formati: <https://www.idp.al/e-drejta-per-informim/>

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe i dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, koordinatorit për të drejtën e informimit. Kërkesa trajtohet nga gjykata sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj.

Kontaktet e koordinatorit ju mund ti gjeni në faqen web të Gjykatave www.gjykata.gov.al, sipas gjykatave respektive.

Kjo fletëpalosje u hartua në bashkëpunim me Institutin Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra ALTRI), me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.



SHËRBIMET QË OFROJNË GJYKATAT PËR QYTETARËT



Në ushtrimin e pushtetit gjyqësor **çdo gjykatë ndihmohet nga administrata gjyqësore**, e cila përfshin shërbimet e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe shërbime të tjera mbështetëse.

Ofrimi i shërbimeve nga gjykatat bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve efikente dhe të aksesueshme për çdo person.

Cilët janë shërbimet që ofron administrata gjyqësore ?

Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme:

- **shërbime gjyqësore**, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore;
- **shërbime administrative**, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore;
- **shërbime mbështetëse si**, kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupit gjykues dhe kryesuesit të seancës, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me rregullin dhe sjelljen e për shtatshme gjatë seancës gjyqësore, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës.

Cilët janë disa nga shërbimet që ofrojnë Gjykatat për qytetarët?

- Regjistrimi i kërkesë padive, kërkesave civile apo administrative dhe i çështjeve penale të ardhura nga prokuroria;
- Regjistrimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës;
- Regjistrimi i rekursit, shtesë në rekurs dhe kundërrkurs;
- Regjistrimi i kërkesave për përjashtim gjyqtari /trupi gjykues;
- Regjistrimi i ankesave nga publiku dhe media;
- Lëshimi i vërtetime apo kopjeve të njësuara me origjinalin të akteve procedurale gjyqësore;
- Kopje audio me CD të seancave gjyqësore;
- Transkripte të seancave gjyqësore apo të procesit gjyqësor;
- Fotokopje të dokumenteve të ndryshme;
- Lëshimi i vërtetimeve nga gjykata se kërkuar nuk është në proces gjyqësor;
- Trajtimi i kërkesave për akses në doku mentet e gjykatës (studim dosje);
- Lëshimi i kopjeve të vendimeve gjyqësore, etj;

Shërbimet ofrohen pranë sportelit të shërbimeve në secilën gjykatë.

Sa është tarifa për shërbimin e ofruar?

Për t'u njohur me tarifat gjyqësore në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore dhe Gjykatat e Apelit, klikoni këtu:

<http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/12/VENDIM-NR.641-DAT%C3%8B-23.12.2020-MBI-PROPOZIMIN-P%C3%8BR-LLOJET-DHE-MASAT-E-TARIFAVE-GJYQ%C3%8BSORE-DHE-PROCEDUR%C3%8BN.pdf>

Për t'u njohur me tarifat gjyqësore në Gjykatën e Lartë, klikoni këtu:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/tarifa_sherbimi_gjyqesor_per_publikun_2374.pdf